



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu

Ueb: www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 775

Datë: 13 / 3 / 2026

Senati i Universitetit të Prishtinës, në bazë të kompetencave të përcaktuara në nenin 20 të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe duke marrë parasysh nevojën për të ofruar udhëzime të qarta për përdorimin e përgjegjshëm dhe etik të inteligjencës artificiale gjenerative nga studentët, pas shqyrtimit të Udhëzuesit për studentët e UP-së lidhur me këtë çështje, në mbledhjen e mbajtur më 04.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet** Udhëzuesi për studentët e Universitetit të Prishtinës lidhur me përdorimin e inteligjencës artificiale gjenerative.
- II.** Udhëzuesi nga pika 1 e këtij vendimi është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III.** Njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës obligohen të njoftojnë studentët me përmbajtjen e këtij udhëzuesi.
- IV.** Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senatin e Universitetit të Prishtinës.

A r s y e t i m


Duke marrë parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjive të inteligjencës artificiale gjenerative dhe përdorimin gjithnjë e më të gjerë të tyre në procesin e mësimnxënies, kërkimit shkencor dhe në aktivitetet akademike të studentëve, është paraqitur nevoja për të përcaktuar udhëzime të qarta lidhur me përdorimin e këtyre teknologjive në mjedisin universitar.

Udhëzuesi për studentët e Universitetit të Prishtinës lidhur me përdorimin e inteligjencës artificiale gjenerative, synon të ofrojë orientime për përdorimin e përgjegjshëm, etik dhe transparent të këtyre mjeteve, duke respektuar parimet e integritetit akademik dhe standardet e procesit mësimor.

Me qëllim të krijimit të një qasjeje të qartë dhe të unifikuar për studentët e Universitetit të Prishtinës në përdorimin e inteligjencës artificiale gjenerative në aktivitetet e tyre akademike, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Menaxhmentit të UP-së;
2. Njërive akademike;
3. Departamentit për Çështje Ligjore;
4. Arkivit të UP-së;



Kryetari i Senatit të UP-së,

Prof. Arben Hajrullahu, Rektor.